



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal 05/2025

I Mbajtur në takimin e V-të të rregullt të KK-së me datën 30.05.2025, në sallën e Kuvendit në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtarës për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e V-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarries në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KK-së;
4. Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për zgjerimin e varrezave në Fshatin Cërnillë;
5. Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevoja të banorëve të Sojevës;
6. Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Shtatores të Dëshmorit “Zejnullah Zejna” në Fshatin Sojevë;
7. Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevoja të banorëve të Fshatit Talinovc i Muhaxherëve;
8. Propozim – Vendim për ndryshimin e destinimit të njësisë kadastrale 690-6 Z.K. Talinovc i Jerlive;
9. Propozim – Vendim për aprovin e kërkesave për blerjen e banesave për të cilat ekziston e drejta e parablerjes;
10. Propozim - Vendim për Shpallje Interes i Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale 2342-1 Z.K. Rahovicë, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 2262-0 Z.K. Rahovicë, pronë e Komunës së Ferizajt;
11. Propozim - Vendim për Shpallje Interes i Përgjithshëm-Publik të ngastrave kadastrale; 1059-7 dhe 1059-8 Z.K. Prelez i Jerlive, pronë e Kombinatit Bujqësor Industrial me qëllim të zgjerimit të varrezave të Fshatit Prelez i Jerlive;
12. Propozim - Vendim për këmbimin e ngastrës kadastrale 2435- 1 dhe

- 2435-2 Z.K. Ferizaj, prona private, me pjesën e ngastrës kadastrale 180-10
Z.K. Talinoc i Jerlive, pronë e Komunës Ferizajt;
13. Propozim – Vendim për Miratimin e Plotësim Ndryshimit të Vendimit 01.Nr.30, të datës 28.03.2025, për Bartjen e Mjeteve nga Viti 2024 në Vitin 2025;
 14. Propozim – Vendim për Plotësim Ndryshimin e Vendimit me Nr.01.Nr. 96 të datës 27.09.2024;
 15. Pyetje dhe kërkesa dhe
 16. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoj të pranishmit për pjesëmarrje dhe e lexoi rendin e ditës së lartcekur, dhe pyeti nëse ka dikush diçka rreth rendit të ditës.

Flamur Istrefi pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se: Propozimi që ka ardhë që ka të bëjë me këmbimin, që ka të bëjë me këmbimin në rrugën e “Reçakut” është skandaloze përmua dhe përgjin parlementar të Lidhjes Demokratike, është skandaloze përfaktin se dy pronat s’janë as për nga vlera as për nga përbajtja të njëjtë, prona që do t’ia jepin personit fizik është te spitali i ri, është pronë e cila do të shumëfishohet me kalimin e viteve dhe mbi të gjitha dallon, një gje tjetër që bie në sy, është që dallon destinimi, ku kjo pronë te spitali është e destinuar për banim kolektiv ndërtim të lartë në anën tjetër edhe në aspektin procedural ky propozim nuk duhet të kaloj e para duhet të janë në kufi kadastral të asaj prone, kjo është në kundërshtim pasi njëna është në zonën 2, e tjetra në zonën 7-të dhe tjetra është që propozimi duhet të vij nga kryetari i komunës po edhe kryetari duhet të jepet pas një vlerësimi nga një komision, përmua dhe përlidhjen ky propozim duhet të hiqet dhe më pas të shikohet se si të rregullohet ju faleminderit.

Kryesuesi pyeti nëse ka tjerë për këtë pikë, meqenëse nuk ka përdiskutim, është që të kaloj rendi i ditës?

Me 19 vota për dhe 14 kundër, kalon rendi i ditës.

Procesverbali s’pati vërejtje dhe i njëjti kaloi me 33 vota për.

Kryesuesi e lexoi pikën e 4-të, pasi spati të interesuar përdiskutim kaloi me 33 vota.

Kryesuesi e lexoi pikën e 5-të dhë këtu s’pati të interesuar dhe kaloi me 33 vota për.

Kryesuesi e lexoi pikën e 6-të dhe kaloi me 33 vota për.

Kryesuesi e lexoi pikën e 7-të dhe kaloi me 33 vota për.

Kryesuesi e lexoi pikën e 8-të dhe kaloi me 33 vota për.

Kryesuesi e lexoi pikën e 9-të dhe u hap debati:

Brahim Osmani pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se fillimi shkurt kërkojë që të shtyhet kjo pikë pasi na duhet info shtesë pasi ne njohim shumë veteran që janë në gjendje më të keqe se këta dhe

t'ia bëjmë një çmim për 100 euro për metër, i bije që do ta blejnë këtë banesë për 7000 euro, kur ne njohim veteran edhe me gjendje me te keqe se këta dhe po besojë që po bëjmë një padrejtësi ndaj tyre, të paktën ky kuvend ose duhet të formojë një komision se s'bën kështu.

Arian Imeri pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se dua të lidhem me parafolësin, duhet kuptu një fakt këtu, nuk janë këto banesa sociale dhe ku ne kemi zgjedhur se kujt t'ia japim këto, thjeshtë janë shfrytëzues që kanë kalu mbi 20 vite dhe në bazë të ligjin ku ekziston e drejta e parablerjes po ju jipet një e drejt për t'i blerë.

Ibrahim Hyseni pasi përshëndeti të panishmit theksoi se unë në bazë dy diskutimeve kuptova që janë të kundërtat qëndrimet dhe unë kërkoj që propozuesi të thjeshtoj këtë çështje, pasi ne kemi marr materialin, mirëpo unë po shohë që qëndrimet janë diametralisht të kundërtat ose ju kryesues pasi që dikush duhet ta sqaroj këtë pikë.

Amir Rexhepi pasi përshëndeti të pranishmit, sa për info ne si grup nuk jemi kundër ajo që tha shefi i grupit është që ne po kërkojmë informacione shtesë lidhur me këtë procedurë, pra do të ishte e rregullt që propozuesi ta sqaroj pasi që jam i bindur që shumica se dinë çka kanë me votu.

Arbër Bytyqi pasi që përshëndeti të pranishmit theksoi se realisht Ariani e tha që këtë gjë ja mundëson ligji pasi këto banesa i kanë në shfrytëzim më shumë se 20 vite d.m.th. këta që kanë apliku dhe që ju takon me ligj, pra ligji për parablerje na si kuvend pse mos me ja mundësu këto banesa që i kanë në shfrytëzim tashme.

Brahim Osmani – po besoj që kur i kanë marre këto banesa, i kanë marrë që s'kanë pas ku me jetu edhe pse atëherë i ka pas ato kushte s'besojë që tash i kanë ato kushte dhe tash na duhet me ja dhanë krejt ato banesa, unë e di që ata janë përkrahës të mëdhenj PDK-së, tjetra s'jam kundër, mirëpo ai që si ka pas mundësit, e tash i ka, le tja jep dikujt tjetër me shfrytëzu, ka veteran plot që si kanë kushtet.

Arian Imeri edhe në fillim reagova për atë që po i përfshin veteranët në këtë rast, janë disa prej banesave te ish armata, është e vërtet po s'është mundësia që na mujmë mi nxjerr ata, e mi fut tjerë, pasi që ata i kanë në shfrytëzim në kohë të pa caktuar krejt çka jem tu ba, është që ne jem tu ja legalizu pasi që ata veçse i kanë në afat të pa caktuar ato.

Xhavi Zariqi edhe unë po i them një dy fjalë pasi u diskutu shumë dhe kjo çështje u diskutu disa herë në parim, nëse ua mundëson ligji, s'ka nevojë me ja mundësu kuvendi dhe nëse analizohet që i ka shfrytëzu 20 vjet dhe vendimet e kuvendorit s'janë me mundësi blerje, pasi ato kanë qenë për tu shfrytëzu dhe gjendja ekonomike ka ndryshu pozitivisht dhe është e padrejt dhe dikush që si ka pas renet para 20 viteve ka qenë e arsyshme, mirëpo tash duke pas standart të mirë jetese duhet në parim të rishqyrtohet.

E dyta krejt ata i kanë banesat me pagesë ndërsa asnijëherë si kanë pagu, unë s'paku se di që ka hy asnijë cent nga ato banesa.

Dhe na e dimë që atëherë ja kemi dhënë banesën dhe fëmijët e tij sot bëjën biznes dhe ende jetojnë në atë banesë, ndërsa në rastin konkret, pse mos me ju mundësu me shfrytëzu ende po me ju

mundësu me ble ndonëse në anën tjetër po kërkon me ble, unë jam për me kalu kjo pikë mirëpo e di që është e pa drejt.

Arian Imeri kërkojë falje që po më bjen me dalë disa herë për një pikë, po veç për me skjaru këtë pikë, e para s'janë asnja që i ka dhanë komuna, mirëpo, ka që ka ba mbindërtim që kryesisht janë prej vitit 99-të, kjo te ish armata su kanë e komunës, tek më vonë ju ka dhanë, në kuadër të kësaj liste ska asnje të komunës-sociale po në bazë të ligjit po kërkojnë me ba zgjidhje për këtë çështje.

Verona Isaku pasi përshëndeti të gjithë, atëherë Ariani e qeli një teme tjetër që po e legalizojnë atë, ne si LDK kërkojmë që të shtyhet kjo pikë dhe të formohet një komision për ta vlerësu gjendjen më saktë, pasi që t'i kryesues na e shtjellove shumë kuartë dhe jo si tjerët që po mundohet me u fshehë nëpër fakte, ju faleminderit.

Mimoza Pajaziti unë veç një gja po du me thanë që nuk duhet mi ngatrru gjanat, banesat sociale janë diçka tjetër, ndërsa këto për mundësi për blerje, pse unë me ia dhanë mundësinë dikujt tjetër kur unë jam banor rezident aty hipotetikisht pe marr këtë shembull, këto s'janë banesa si të solidaritetit, pajtjohna me ju kryesues që dikush i ka rrit standardet, po këtu me ia dhanë mundësinë, që është 20 vite aty, ju faleminderit.

Kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë dhe kjo kaloi me 17 vota për, 11 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 10-të dhe pasi s'pati të interesuar për diskutim kaloi me 33 vota për.

Kryesuesi e lexoi pikën e 11-të dhe kaloi me 31 vota për.

Kryesuesi e lexoi pikën e 12-të dhe u hap debati:

Brahim Osmani pasi përshëndeti të pranishmit theksoi: edhe në herën e parë kemi qenë kundër kësaj pike ku këtu si kem as drejtorët me prezantu, kemi qenë kundër, tashmë komuna ka fillu me marrë llajsne e me dhanë tokë në zemër të qytetit, spo muj me kuptu edhe ju qysh mundeni me dhanë ose me ba këtë këmbim, e keni vendos anej zemrën e qytetit, ne jemi kundër dhe do ta kundërshtojmë në çdo formë që mundemi.

Amir Rexhepi që nga fillimi e kemi kundërshtu këtë pikë, veç këqyrne çka o tu marr komuna dhe çka përfiton komuna këtu, jemi tu e marrë kulmin e KEDS-it dhe jemi t'i dhanë një këmbim të lartë, pra me ba edhe ma shumë milioner atë parashtruesin e kërkuesës pra.

Gëzim Haxhimusa pasi përshëndeti të pranishmit, theksoi se po mban përshtypje pse se kemi Drejtorin Sabri, që 4 vjet materiali na vjen pa ngjyrë dhe e vetmja pikë që ka ardhë më ngjyrë o kjo pse?

Faik Selmani dola veç me skjaru që gjeoportali i Vtit para 2018 del ashtu ndërsa i 2024 del me ngjyrë.

Kryesuesi konstatoi se duhet të ndërprehet për 10 minuta pasi s'kemi korum.

Kryesuesi e lexoi pikën e 13-të dhe kaloi me 30 vota për .

Kryesuesi e lexoi pikën e 14-të dhe e hapi diskutimin:

Te Komogllava kryesuesi theksoi se duhet një skjarim pasi shefat e grupeve kemi qene në vend të ngjarjes, kemi konstatu se varreza afër ka, mirëpo në atë hapësirë që ja kemi dhanë, e qe po kërkojnë me ju marrë, mund të ketë pas, por ska, i kam dy ankesa, një e atyre që pretendojnë që ka varreza dhe një që ska. Unë mendoj dhe kërkoj që t'i qëndrojmë vendimit paraprak pasi që aty u investu.

Brahim Osmani pasi falënderoj, ne kemi qenë në vendngjarje, ata kanë probleme në mes vete dhe jo që ka diqka, aty veq u investu tashme dhe kërkojë të jetë si ka qenë.

Arian Imeri pjesë e vizite kam qenë edhe unë, mirëpo nëse ka mundësi me ba kompromisë, një pjesë më kthy për varreza e një për parking që të jemi për të dy palët, pasi tash me pa ska varreza, mirëpo në të kalumen ka qenë e destinume për varreza.

Flamur Istrefi pjesë e takimit kam qenë edhe unë dhe kërkoj që të jetë vendimi i 2024 në fuqi dhe kompromisi të bëhet jashtë kuvendit.

Sadat Ismajli pasi përshëndeti të pranishmit, unë kryesus jam marr me atë çështje, duhet pasur parasysh që aty varreza ska pas, mirëpo për që ka qenë e destinuar për varreza ka qenë, unë kërkojë që të formohet një komision dhe të mirret gjendja faktike dhe më pas të shikojmë qka do të ndodhë aty, pasi so interes as i yni, që atje te kenë probleme.

Kjo pikë u propozua që të anulohet dhe u anulua me 18 vota për, 8 kundër.

Kryesuesi e lexoi pikën e 15-të që është Propozim -Vendim për shpalljen interes i përgjithshëm 3523-1 Z.K. Ferizaj me qëllim të këmbimit me 188-1 Z.K. Talinovc i Jerlive pronë e komunës së Ferizajt kjo pikë u propozua si pikë shtesë në kuvend.

Flamur Istefi prap i qëndroj asaj, një propozim që ska propozim zyrtar nga kryetari ne do t'i ndjekim të gjitha procedurat për ta anuluar këtë pikë, andaj edhe kërkojë që të shtyhet.

kaloi me 18 vota për, 13 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 16-të për listë rezervë dhe fjalën e mori Faik Selmani i cili theksoi:

S'pari ta skjaroj çështjen me Mimozën, se patëm mosmarrëveshje, na i marrim emrat dhe i krahasojmë me listat paraprake, nëse dikund është ai emër nuk mund ta përsërisim, është punë e kryne, lista e 2021 është valide dhe kjo listë është plotësim i asaj liste edhe kjo që po plotësohet është që kërkohen të largohen emrat e dyfishta p.sh. edhe te sheshet kërkohet që të largohen emrat e dyfisht pasi s'mundemi edhe rrugë edhe shesh ta dini që këto agjencioni pi kthen.

Mimoza Pajaziti pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që unë kom kërkoi që të vihet lista përfundimtare se e di që t'i shohim mirëpo unë spe di kush ka mbet, unë si asamblesite po du me pa listën komplet, kjo është veç kërkesa ime.

Faik Selmani e skjarova punën e shesheve Imri Ilazi mbetet veç shesh.

Kjo pikë kaloi me 28 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi theksoi që kemi një propozim që do ta plotësojmë një gabim teknik të vendimit të PZHK-së vetëm sa i përket pikës 3 dhe do të plotësohet kështu.

Dretori propozon që pika 3 të bëhet ashtu si ka propozu Amir Rexhepi, ku thotë të pajisen me leje ndërtimore të gjithë ata që kanë përfunduar të gjitha procedurat,

Kjo pikë kaloi me 17 vota për, 0 kundër dhe 4 abstenim.

Pyetje kërkesa:

Hatixhe Bungu Qerimi:

Në emër të interesit qytetar për transparencë dhe llogaridhënie në ndarjen e subvencioneve për Vitin 2025, ju kërkoj që të bëhen publike këto informacione lidhur me procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së përfituesve:

1. Përbërja e Komisionit Vlerësues;
2. Tabela e pikëve për secilën OJQ aplikuese;
3. Portofolët dyvjeçarë të OJQ-ve, të cilët kanë qenë pjesë e kritereve për vlerësim dhe ndarje të fondeve.

Pas publikimit të listës së përfituesve, kemi pranuar reagime nga qytetarët të cilët kërkojnë sqarime se si janë shpërndarë mjetet publike dhe nëse përfituesit kanë dëshmuar vërtet angazhim dhe ndikim në komunitet. Duke marrë parasysh që këto fonde burojnë nga taksat e qytetarëve, është e drejtë legjitime e tyre të kenë qasje në informacione të tillë.

Prandaj, kërkojë që të gjitha materialet e përmendura më sipër të publikohen në mënyrë transparente në faqen zyrtare të komunës

Besim Haziri kam një pytje?, për kryetarët e fshatrave pasi ata që 2 vjet gati janë zgjedh dhe ende s'jan certifiku, mendoj qe është e pa drejt, qytetarët mendojnë që kanë kryetar, ndërsa ata s'janë certifiku, kjo duhet të skjarohet.

Amir Rexhepi une pajtjona me kolegen asambleiste, na kemi marr shumë skjarime, pasi ka përfitues që s'kan fillu fare projekti dhe kërkoj që të vij këtu komisioni që të vij të raportoj dhe të naj hjek këto dilema.

Verona Isaku:

Dua të ngre një shqetësim serioz në lidhje me punimet që kanë nisur në rrugën "Brigada 161". Këto punime kanë filluar pa asnjë konsultim paraprak me banorët e zonës – pa asnjë dëgjim publik, pa njoftim zyrtar, pa përfshirje të komunitetit.

Si rezultat i kësaj qasjeje të pakoordinuar dhe jotronsparente, banorët dhe bizneset që veprojnë në komplekset përreth janë lënë pa parkingje funksionale. Po flasim për hapësira që, në momentin kur janë blerë apartamentet apo njësitë afarisë, janë prezantuar si "Parkingje të përbashkëta". Sot, ato janë bërë të papërdorshme ose të paqasshme.

Ky nuk është vetëm një problem teknik apo logistik. Ky është

një shembull i qartë i mungesës së transparencës dhe i mosrespektimit të të drejtave të qytetarëve – si pronarë, sipërdorues të përditshëm të kësaj infrast - rukture, por mbi të gjitha, si taksapagues.

Ne nuk mund të lejojmë që vendimmarrja për hapësirat publike dhe për infrastrukturën e përbashkët të bëhet pa përfshirjen e komunitetit. Kjo sjellje duhet të marr fund.

Prandaj, kërkojë që komuna të ndalojë së anashkaluar qytetarët në proceset vendimmarrëse, të ofrojë sqarime të qarta mbi këtë projekt dhe të angazhohet urgjentisht në një dialog të hapur me banorët e rrugës “Brigada 161” për të gjetur një zgjidhje që respekton pronësinë, lirinë e lëvizjes dhe të drejtën për informim.

Gjithashtu,

Dua të ngre sot një shqetësim të madh që po ndan komunitetin e banorëve dhe bizneseve në rrugën “William Walker”, ose siç njihet nga të gjithë qytetarët – “rruga e Loçkës”.

Bëhet fjalë për një rrugë që e dimë të gjithë sa e ngushtë është, sa sfiduese është për qarkullim dhe sa e rrezikshme bëhet gjatë orëve të ngarkuara. Por, së fundmi, vendosja e pengesave fizike në këtë rrugë ka përkeqësuar edhe më tejë situatën.

Këto pengesa nuk janë vetëm një pengesë për lëvizjen e lirë të qytetarëve – ato përbëjnë një rrezik të drejtpërdrejtë përsigurinë publike. Rruga tashmë është e ngushtë, dhe me këto ndërhyrje është bërë praktikisht e pakalueshme në raste urgjente.

Prandaj, në këtë foltore dua të bëjë disa pyetje që kërkojnë përgjigje të drejtpërdrejta dhe publike:

- Kush i ka vendosur këto pengesa në rrugën “William Walker”?
- A është marrë ndonjë leje për vendosjen e tyre?
- Nëse po
 - mbi çfarë baze është lëshuar kjo leje dhe a është bërë ndonjëherë një vlerësim i ndikimit të tyre në rastet emergjente?

Qytetarët meritojnë përgjigje. Meritojnë transparencë. Dhe mbi të gjitha, meritojnë siguri.

Kërkojë nga komuna që të marrë urgjentisht masa për të adresuar këtë çështje dhe të sigurojë që vendime të tillë të mos merren më pa analizë, pa leje dhe pa menduar pasojat për komunitetin.

Brahim Osmani kam disa kërkesa nga Fshati Mirosalë te Qendra kulturës, atje ka kohë që u djegë dhe Drejtoria kulturës, ska bë asgjë atje, çështja tjetër është në Fshatin Dremjak është Lagjja “Jahaj” nuk i rregullohet rruga për shkak të partive politike, është mirë të interevenohet meniherë atje.

Faik Selmani e kam një shqetësim të një qytetari, një sulm paska ndodhë nga qenët endacak, dua vetëm ta përcjell në kuvend.

Kryesuesi pyeti nëse ka tjerë për diskutim dhe pasi s'pati kryesuesi e mbylli këtë seancë.

Procesmbajtësi



Leutrim Mahmuti

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi